



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSA" VLORE

VENDIM

Nr. 1, Dt.19.01.2012

Per miratim ne parim te kerkeses, per perdorim me koncension, te formes BOT, te burimit uJOR, "Sasaj", "Per imbotilim te ujit te pijshem, per transportim dhe eksportim te ujit", subjektit "Blue Eye One" sh.p.k, me perfaqesuese ligjore Znj. Sofie Merkaj ,investitor Z. Fatmir Merkaj, Tirane.

Ne zbatim te Ligjit Nr.8093 Dt.21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", te percaktuara ne nenet 8 pika 1, neni 14 pika 1, shkronja dh, neni 18, ligjit nr. 9663, dt.18.12.2006 "Per koncesionet", Vendimit te K.M-ve nr. 27, dt. 19.01.2007, "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve", kreut III-pika 1 "Per propozimet e kerkuara", si dhe te vendimit nr.1, dt. 07.06.2007 te K.K.U-se, "Per disa ndryshime ne vendimin nr.2, dt. 19.07.2001, te K.K.U, per miratimin e formulareve te kerkeses per leje, autorizim e koncension, si dhe te formulareve tip te vetedeklarimit, lejes e autorizim per perdorimin e rezervave ujore", duke pare dhe te dhenat e studimit dhe formularin e autodeklarimit, te subjektit "Blue Eye One" sh.p.k

K.B.U "Vjose":

VENDOSI:

- 1- Miratimin ne parim te kerkeses, per perdorimin me koncension, te formes BOT, te burimit uJOR, "Sasaj", *per imbotilim te ujit te pijshem, per transportim dhe eksportim te ujit*, subjektit "Blue Eye One" sh.p.k, me perfaqesuese ligjore Znj. Sofie Merkaj, Tirane. Me vendmarrje uji ne vendin me koordinata:
X = 44 31 146.44 Y = 44 06 531 Z = 42 m
- 2-Sasia e ujit qe mund te jepet ne perdorim me koncension te formes BOT, do te percaktohet nga S.T.K.K.U, me qellim qe te kihet parasysh plani i menaxhimit te ujerave.
- 3-Subjekti "Blue Eye One" sh.p.k, do ti nenshtrohet procedurave te konkurimit, sipas kerkesave Te ligjit nr.9663, dt.18.12.2006 "Per koncesionet" dhe vendimit nr. 27, dt. 19.01.2007, "Per Miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve", kreut III-pika 1 "Per propozimet e kerkuara".
- 4 – Subjekti "Blue Eye One" sh.p.k, te paraqitet prane autoritetit kontraktues dhe njesise te trajtimit te koncesioneve, per vazhdimin e procedurave.
- 5 -Ngarkohet A.U.B "Vjose" per zbatimin e ketij vendimi.
- 6- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJES I A.U.B "VJOSE"
Ardian DINE

KRYETARI I K.B.U "VJOSE"
Eduart VELCANI